



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL

(i përmbledhur)¹

Tiranë, më 23.12.2020, ora 13.15

**Drejton mbledhjen -
Vitore Tusha – zv/Kryetar i Këshillit**

Rendi i Ditës:

1. Shqyrtimi i gjetjeve në procedurën e verifikimit për kandidatin për vendin vakant, vakancë e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese, e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019:

- Zhaklina Peto.

2. Vendimmarrja lidhur me lejimin/ndalimin e kandidimit të kandidatit të mësipërm.

Marrin pjesë:

1. Vitore Tusha	(zv/kryetar)
2. Fiona Papajorgji	(anëtare)
3. Arta Marku	(anëtare)
4. Miranda Andoni	(anëtare)
5. Saida Dollani	(anëtare)
6. Ludovik Dodaj	(anëtar)
7. Fatjona Memçaj	(anëtare)

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme:

1. **Erinda Ballanca, Avokate e Popullit.**

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

1. **Bledar Dervishaj**, përfaqësues me autorizim i Presidentit të Republikës.

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja “d”, neni232 pika 2, neni 242 shkronja “c”) dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike diskutimet e vetë anëtarëve të KED për çështjen e rendit të ditës, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

HAPET MBLEDHJA

Vitore Tusha hap mbledhjen dhe parashtron se mbledhja nuk po fillon në orën 12:00, siç ishte thirrur në rendin e ditës, pasi për shkak të disa komunikimeve të fundit që ishin të domosdoshme është vlerësuar dhe është rënë dakord që të fillojë pak më vonë. Kjo mbledhje është thirrur për shqyrtimin e gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidatës Zhaklina Peto, për vendin vakant, vakancë e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese, e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019, dhe vendimmarrjen lidhur me lejimin/ndalimin e kandidimit të kësaj kandidate.

Propozon që në rendin e ditës të shtohet edhe miratimi i procesverbalit të përmbledhur të mbledhjes së KED të datës 21.12.2020, me të cilin janë njohur të gjithë dhe në të janë reflektuar edhe komentet dhe sugjerimet.

Verifikon praninë e anëtarëve dhe pjesëmarrësve në mbledhje. Anëtarët janë të pranishëm. Po ashtu është e pranishme Avokati i Popullit dhe përfaqësuesi i Presidentit të Republikës, por nuk është e pranishme përfaqësuesja e Kryetarit të Kuvendit dhe as përfaqësuesit e Komisionit të Ligjeve.

Anëtarët shprehen se janë dakord me rendin e ditës dhe miratojnë procesverbalin e përmbledhur të mbledhjes së KED të datës 21.12.2020.

Vitore Tusha pyet nëse përfaqësuesit e Avokatit të Popullit dhe Presidentit kanë gjë për të shtuar?

Erinda Ballanca shprehet se nuk ka komente.

Vitore Tusha vijon me rendin e ditës që lidhet me shqyrtimin e gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidatit Zhaklina Peto, për vendin për vendin vakant, vakancë e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019. I jap fjalën relatores Miranda Andoni.

Miranda Andoni merr fjalën dhe shprehet se pas komunikimit të relacionit kandidatës prej saj janë dërguar kërkesa dhe informacion të gjithë anëtarëve të Këshillit, me të cilat janë njohur të gjithë, ndaj vlerëson se ndoshta është me interes të diskutohet paraprakisht në lidhje me një kërkesë që kandidatja ka paraqitur për ecurinë e shqyrtimit të kësaj vakance. Sqaron se kandidatja fillimisht ka pretenduar në lidhje me kohën në të cilën është vënë në dijeni për relacionin, ka shprehur mendimet e saj në lidhje me çfarë i është kërkuar, shpjegime dhe qëndrime që ajo duhet të shprehte në lidhje me sa i është kërkuar nga Këshilli anëtarëve dhe relator. Në vijim dhe në përfundim kandidatja është shprehur se “...në rast se vendimmarrja juaj në mbledhjen e datës 23.12.2020 për lejimin apo ndalimin e kandidaturës sime duhet të bazohet në këtë procedurë dhe në këtë relacion të kundraligjshme i cili më është dërguar vetëm dje në orën 16.14 do ju lutesha të merrnit në konsideratë dorëheqjen time”.

Bazuar në këtë paragraf të fundit të këtij komunikimi me kandidaten, relatorja shprehet që përpara se të relatojë çështjen ndoshta duhet të shprehet ndonjë mendim në lidhje me këtë kërkesë të paraqitur prej kandidatës. Në cilësinë e relatores, me t'u njohur me këtë informacion, i është dërguar në orën 11.38 nga adresa “këshilli 3” nëpërmjet postës elektronike, një e-mail duke i kërkuar që bazuar në atë që ka shprehur si më sipër ajo duhet të qartësojë qëndrimin saj dhe duhet të shprehë qartë vullnetin në lidhje me vijimin e konkurrimit për vakancën që shqyrtohet ditën e sotme në orën 12.00. Sqaron se që prej orës 11.38 që i është dërguar kandidatës e-maili dhe deri në këto momente nuk ka asnjë përgjigje në lidhje mesa i është kërkuar. Po ashtu është tentuar nga sekretaria e KED që të komunikohet me kandidaten nëpërmjet numrit telefonik që ajo vetë ka dorëzuar për komunikim por kjo nuk ka qenë e mundur për shkak se ky numër telefoni rezulton i mbyllur. Personalisht vlerëson se qëndrimi nuk është i prerë dhe i qartë dhe prandaj i ka kërkuar kandidatës që ajo të shprehë përsëri vullnetin e për vijimin e kësaj procedure.

Vitore Tusha, në lidhje me sugjerimin e relatores, kërkon që anëtarët të shprehen paraprakisht nëse janë dakord që të diskutojnë tani apo të vijohet me gjetjet e relacionit dhe më pas të analizohen të gjitha.

Fiona Papajorgji merr fjalën. Mendon se më mirë do të ishte që të ketë një analizë të plotë të situatës duke qenë se dorëheqja duket sikur është e kushtëzuar, ndaj preferon të analizohet e gjithë situata pra gjithë shpjegimet në relacion dhe pastaj kur të vijë momenti i diskutimit të merret parasysh edhe fakti i dorëheqjes.

Arta Marku shprehet se mendon që relatorja të relatojë të plotë relacionin me të gjitha përgjigjet që kanë ardhur dhe pastaj të diskutohet dorëheqja.

Saida Dollani shprehet se dorëheqje të kushtëzuar sipas të gjithë të drejtës pozitive nuk ka. Vullneti është ose dorëhiqet ose vazhdojmë procedurat, në kuptimin që duke qenë e drejta për të konkurruar një e drejtë, dhe si e tillë disponohet nga vetë ai që ushtron të drejtën, po ashtu dhe dorëheqja është një e drejtë dhe disponohet po nga ai që kërkon të konkurrojë. Në këtë kuptim nuk e shikon të lidhur me kushtin që ka ardhur sepse duke qenë se ka një dorëheqje të kushtëzuar, mendon që të shprehen nëse është një dorëheqje e qartë apo është një ushtrim presioni ndaj Këshillit. Për ta sqaruar më tej këtë ushtrim presioni në kuptimin që Këshilli të mos dijë si të veprojë. Nëse vepron p.sh. dhe thotë që ka dhënë dorëheqjen zonja ta kundërshtojë dhe të thotë dorëheqja ime s'është e qartë, si i thamë ndërprerjen për këtë shkak. Nëse vazhdon Këshilli të japë një vendim dhe të thojë po unë kam dhënë dorëheqjen dhe si i tha Këshilli të vazhdojë. Në këtë kuptim kam e vlerëson se është një lloj presioni, duke vënë Këshillin në një udhëkryq dhe për të zgjidhur këtë udhëkryq mendon që të shprehen në këtë moment dhe më pas të shprehen se si do procedohet.

Ludovik Dodaj mendon se janë të diskutueshme të dyja opsionet, pra dhe relacioni por edhe për të parë nëse shprehja në mënyrën që është e kushtëzuar dmth. prek këtë procesin në këtë fazë apo pasi të shqyrtohet në tërësi relacioni. Këto janë dy çështje që duhen diskutuar dhe të vlerësohet në këtë fazë.

Fatjona Memçaj merr fjalën. Nuk e sheh normale që të vijohet me relacionin dhe pastaj të vazhdohet nëse ka apo jo dorëheqje. Gjykon që Këshilli duhet të shprehet për qëndrimin e tij nëse mënyra e të shprehurit në kërkesën që është drejtuar konsiderohet apo jo dorëheqje dhe nëse nuk konsiderohet e tillë të vazhdohet me leximin e relacionit dhe procedurën. Nëse Këshilli vazhdon me leximin e relacionit ka pranuar që po vijohet procedura, por jemi përpara një fakti të ri të cilin duhet ta shqyrtojë.

Vitore Tusha i jep fjalën Avokates së Popullit.

Erinda Ballanca merr fjalën: “Informacioni i paraqitur apo kjo shkresë e cila ka ardhur sot në Këshill është pjesë e një komunikimi elektronik të kandidates me këshillin, i cili si lëndë ka percaktimin “kërkesë” që do të thotë se ka një kërkim nga pala për këshillin. Ky është qëndrimi që ajo mban në kokë në lëndën e komunikimit elektronik i cili i është dërguar në orën 10 e 20 minuta . Këshillit sot. Nga leximi në tërësi tekstit bashkelidhur email, në maksimumin e vet mund të dalin dy kërtime, një kërkim që ka të bëjë me pezullimin e procedurës dhe mosvazhdimin e saj, për shkak se ajo e quan atë të paligjshme apo se nuk i është dhënë mundësia të bëjë një mbrojtje efektive ligjore. dhe nëse ky kërkim nuk realizohet ajo e konsideron se duhet të japi dorëheqje pasi konsideron se në këto kushte citoj “të paprecedentë të nderuar anetarë të KED une kërkoj mirëkuptimin tuaj dhe respektimin e parimeve bazë kushtetuese dhe procedurale në rast se vendimmarrja juaj e mbledhjes se datës 23.12.2020 për lejimin apo ndalimin e kandidaturës sime do vazhdoje mbi këtë procedure apo këtë relacion i cili me është dërguar vetëm dje do lutesha të merrnit në konsiderate dorëheqjen time”. Pra o konsiderohet kjo kërkesë një kërkesë vetëm për dorëheqjen për shkak të lëndës ose konsiderohen dy kërkesa në maksimumin e interpretimit të vullnetit të palës pra nëse pala ka dy kërkesa mendoj që Këshilli t'i përgjigjet të dyjave kërkesave të palës për efekt procedural. Në rast se Këshilli konsideron se ka vetëm një kërkesë, kërkesa është konsiderata për dorëheqjen e

kandidatit. Të dyja janë në vullnetin e Këshillit dhe janë në tagrin e tij për t'i realizuar. Në lidhje me vijueshmërinë e procesit unë jam në dijeni të faktit se relatorja e ka ndarë çështjen e problemit shëndetsor me Këshillin. Ky fakt u është bërë me dije dhe është ndarë nga relatorja me anëtarët e Këshillit, dhe nuk është një veprim apo komunikim të cilën relatorja e ka kryer pa e ndarë me anëtarët e tjerë. Rezulton se në gjithë veprimtarinë që ajo ka kryer deri më tani ia ka bërë me dije Këshillit.”.

Vitore Tusha vëren se nga diskutimet se ka një shumicë që e vlerëson që Këshilli duhet të marrë një vendim paraprak në lidhje me njëren nga kërkesat e paraqitura nga kandidatja, atë për t'u tërhequr nga konkurrimi. Komunikon që të ndërpritet mbledhja për të vijuar në dhomë këshillimi me votimin.

Ndërpritet mbledhja.

Rifillon mbledhja.

Vitore Tusha vijon mbledhjen. Komunikon që Këshilli, me vendim të ndërmjetëm vendosi që të vijojë procedurën duke bërë pjesë të relacionit edhe dokumentin e përcjellë sot nga kandidatja dhe kërkon nga relatorja që të relatohen në mënyrë më të veçantë, specifike, të gjitha veprimet hetimore të kryera pas vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit. I jep fjalën relatores.

Miranda Andoni parashtron relatimin për kandidaten Zhaklina Peto për vakancën e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019.

Vitore Tusha ndërhyt dhe pasqyron faktin se Avokatja e Popullit u largua në këtë moment për shkak të një impenjimi shumë të rëndësishëm zyrtar i ndodhur në këtë moment.

I jep fjalën relatores të vijoje me relatimin e çështjes.

Miranda Andoni vijon me parashtrimin e relatimit për kandidaten Zhaklina Peto. Sqaron se e gjithë përmbajtja e kërkesës për sqarimin pyetjeve të drejtuara është pasqyruar në relacion në faqen 17 deri në faqen 20 të tij.

Saida Dollani ndërhyt dhe shprehet se e kanë lexuar relacionin por pyet se cila është kërkesa e kandidates.

Miranda Andoni vijon me leximin e relacionit. Ky është relacioni i bërë prej relatores dhe është përcjellë në kushtet kur skadoi afati që i është lënë kandidates për të paraqitur shpjegime dhe sqarimet e kërkuara dhe ai i është përcjellë zv/kryetares. Pas dorëzimit të relacionit dhe njoftimit të tij kandidates, për njoftimin e të cilit kandidatja ka pretendime se është vënë në dijeni më vonë nga ana e Këshillit dhe ditën e mbledhjes e ka marrë vesh nga media dhe ka paraqitur nëpërmjet e-mailit një kërkesë duke kërkuar që të bëhet pjesë e mbledhjes.

Saida Dollani pyet nëse akti përmban titullin kërkesë.

Miranda Andoni përgjigjet se më e-mail lënda është kërkesë parashtruar anëtarëve të KED-së.

Vitore Tusha kërkon që të trajtohet si pjesë e mbledhjes së ditës së sotme edhe kjo kërkesë.

Miranda Andoni shprehet se para e-mailit të datës 23 (dita e sotme) ka një e-mail të datës 22.12, në orën 7.50, me të cilin kandidatja i është drejtuar relatores dhe thotë që pak orë ka që është vënë në dijeni për relacionin dhe në mënyrë të arsyeshme ka kërkuar kohë. Ndërkohë në lidhje me veprimet me DPT kandidati thotë se Këshilli i ka dërguar një shkresë DPT, ku i kërkohet informacion. Në përgjigjen e saj DRT informon se ka dërguar shkresën për paraqitjen e një dokumentacioni. Sipas kandidates ky paragraf nuk është i pasqyruar qëllimisht në relacionin e dërguar, dhe ajo ka marrë dijeni për shkresën e DRT nr.29245/3, datë 21.12.2020, të cilën e ka vënë në dispozicion të KED, bashkëlidhur e-maili.

Relatorja shprehet se kjo është një dërgim informacioni dhe për kandidaten dhe për KED dhe se në fakt janë vënë në dijeni nga kandidati lidhur me këtë shkresë. Bashkë me këtë shkresë kandidatja ka vënë në dispozicion disa akte, vendime të VKM dhe një urdhër që ka lidhje me kontraktuesin për banesën apartament. Prej kandidatës është paraqitur dhe një kërkesë, për të cilën janë vënë në dijeni të gjithë anëtarët e Këshillit. Sipas përmbajtjes së kësaj kërkesë thuhet se nëpërmjet e-mailit të datës 23.12.2020, ora 10.21 të titulluar në lëndë kërkesë drejtuar anëtarëve të KED-së kandidatja Zhaklina Peto shprehet se i është drejtuar relatores dhe anëtarëve të KED për shkelje të rënda procedurale të deritanishme si shkelje shumë të rënda të relacionit të përgatitur nga relatorja. Në vijim kandidatja bën me dije se ka komunikuar nëpërmjet postës elektronike për deklarimin e të ardhurave të shitjes së automjetit, ka bërë deklaratimet individuale vjetore për transaksionet, ka kryer deklarime dhe se në relacionin e dërguar nga relatorja ka fshehur shkresën e DRT dërguar KED. Relatorja sqaron se shkresa nr. 29245/3 prot., datë 21.12.2020 nuk ka mbërritur në KED.

Vitore Tusha pyet nëse shkresa nuk ka arritur as tani që po flasin?

Miranda Andoni përgjigjet se jo dhe se kandidatja e akuzon atë si relatores që e ka fshehur këtë shkresë ndaj po e citon më shumë. Vijon me pretendimet e kandidatës që shprehet se në lidhje me pasurinë apartament referuar urdhrin nr. 6 të Ministrisë së Financave, me të cilin është urdhëruar sekuestrimi i aseteve të shtetasit Abdullah Alejsalem, fsheh faktin dhe nuk citon se personi në fjalë është hequr nga lista me vendimin nr. 86 të Këshillit të Ministrave.

Relatorja i ka mohuar kërkesën për shtyrje të procesit pavarësisht diagnostifikimit të saj dhe gjendjes shëndetësore, duke e penguar për të mbledhur dokumentet dhe informacionet e nevojshme.

I është mohuar e drejta e saj për mbrojtje efektive ligjore dhe i është mohuar mundësia për të paraqitur parashtrime dhe duke kërkuar mirëkuptimin dhe respektimin e parimeve bazë kushtetuese dhe procedurale shprehet se në rast se vendimmarrja e mbledhjes së datës 23.12.2020 për lejimin apo ndalimin e kandidaturës së saj do vazhdojë mbi këtë procedure dhe këtë relacion, i cili i është dërguar dje në orën 16.14, shprehet se “do tju lutesha të merrnit në konsiderate dorëheqjen time.”.

Vitore Tusha pyet relatores nëse përtej akteve që janë përfshirë në relacion ka dhe dy akte shtesë, komunikimi i mbrëmshëm i orës 19 i kandidatës me relatores dhe komunikimi në datën 23, ora 10.21 me të gjithë anëtarët. Vetëm këto dy akte nuk janë bërë pjesë e relacionit të përcjellë kandidatës dhe këto u bënë pjesë të shqyrtimit nga ky Këshill?

Miranda Andoni përgjigjet se po, këto janë aktet që ka relatuar.

Vitore Tusha në lidhje me shkresën e tatimeve, e cila është përcjellë nga kandidatja por që deri në këtë moment në zyrën e KED nuk ka ardhur, shprehet që ajo do merret në shqyrtim nga Këshilli.

Vitore Tusha pyet anëtarët nëse janë dakord për këtë procedurë të vlerësimit. Pavarësisht se u mor një vendim i ndërmjetëm dhe tashmë t'i analizojmë dhe t'i vlerësojmë, të administrojmë çdo kërkesë të ardhur deri në këtë moment në Këshill.

Anëtarët shprehen se janë dakord që të administrohen kërkesat dhe dokumentet e paraqitura nga kandidatja.

Vitore Tusha pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo sqarime.

Anëtarët nuk kanë pyetje apo sqarime.

Vitore Tusha i jep fjalën përfaqësuesit të Presidentit.

Bledar Dervishaj shprehet se pavarësisht vendimmarrjes së Këshillit, që me sa duket do jetë ose përfundimi i procedimit administrativ ose shqyrtimi në themel, përsërit të njëjtën kërkesë, tashmë të përsitur qoftë në formë shkresore nga Presidenti i Republikës, apo prej katër apo pesë herësh të shprehur në mbledhje, që Këshilli të vijojë me procesin e vlerësimit të kandidatëve të kualifikuar, në momentin të mbylljes së procesit të verifikimit, kjo në mbështetje

të nenit 238-240 të ligjit nr. 115/2016. Sa më shpejt të ndodhë kjo aq më mirë edhe për organin e emërtesës.

Vitore Tusha deklaron të mbyllur mbledhjen për të vijuar me vendimmarrjen në lidhje me shqyrtimin e gjetjeve për këtë kandidaturë.

Mbyllet mbledhja në orën _____

Tiranë më datë 23.12.2020

SEKRETARE

Ermelinda KADIU

Dorina Dulaj

Vilma Dokushi

Elona Kardhiqi

ANËTARE

Arta MARKU

ANËTARE

Fiona PAPAJORGJI

Zv/KRYETARE

Vitore TUSHA

ANËTARE

Ludovik DODAJ

ANËTARE

Miranda ANDONI

ANËTARE

Saida DOLLANI

ANËTARE

Fajtona MEMÇAJ